

Vendim nr. 281 datë 25.11.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, në datën 25.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

PETRIT ALIAJ

OBJEKTI:

Kundërshtimi i vendimit nr. 158, datë 11.07.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve për mossaktësimin e pretendimeve të paraqitura në kërkesën nr. 524 prot., datë 06.06.2024. Kërkesat janë shkruar të sakta në pikën 12 të vendimit nr. 158/2024, por pa dhënë përgjigje në asnjë vendim të dhënë nga viti 2020-2024 për afatin 4-mujor të paraqitjes së kërkesës në vitin 2013 në Gjykatë, si dhe për shterimin e mjeteve juridike efektive të ankimeve. E përsëris: a) afati 4-mujor ekzistonte në ligjin nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 99, datë 06.10.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000”.

b) shterimi i mjeteve juridike të ankimit ekzistonte në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e pandryshuar nga ligji nr. 76, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”.

Kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është paraqitur në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë në datën 10.07.2013, sipas ligjeve ekzistuese të çastit të lindjes së të drejtës të garantuar

në Kushtetutë dhe ligje, si dhe nenet 442, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile, ende të pashfuqizuara.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 44, 48, 52, pika 2 , 124, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Petrit Aliaj në datën 21.09.2020 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 1441, datë 14.07.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, të dhëna në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar për gjykimin e kërkesëpadsisë së tij, me objekt rillogaritjen e pensionit të ushtarakut.

2. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 99, datë 16.11.2020 (*vendimi nr. 99/2020*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione temporis*, pasi kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

3. Në vijim, në datën 18.01.2021, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, kurse me kërkesën e datës 22.03.2021 ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për rillogaritjen e pensionit të tij. Pas shqyrtimit të kërkesave, Kolegjet e Gjykatës, me vendimet nr. 30, datë 12.02.2021 dhe nr. 82, datë 01.06.2021, kanë vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

4. Kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesën e datës 22.07.2021 për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, si dhe pavlefshmërinë e vendimeve të sipërcituara të kolegjeve të kësaj Gjykate. Në lidhje me këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve

të Gjykatës, me vendimin nr. 134, datë 01.12.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke arritur në përfundimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione temporis* për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore dhe vendimet e kolegjeve të kësaj Gjykate nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë asaj. Mbledhja e Gjyqtarëve ka vërejtur, gjithashtu, se edhe pse kërkuesi ka marrë përgjigje se nuk ka respektuar afatin ligjor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ai ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura, për të njëjtin objekt dhe shkak.

5. Pavarësisht për sa më sipër, me kërkesën e datës 05.04.2022 kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës, duke pretenduar moszbatimin e kritereve në shqyrtimin paraprak të kërkesës së tij, në kuptim të kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, si dhe shkelje të rënda në proceset e zhvilluara në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 79, datë 06.07.2022, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pasi kërkuesi ka përsëritur po të njëjtat pretendime dhe nuk ka parashtruar asnjë shkak të ri për të mbështetur pretendimet e tij në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme.

6. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Kolegjit, në datën 29.07.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se po parashtronte një shkak të ri në mbështetje të pretendimeve të tij. Pas shqyrtimit, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 120, datë 28.09.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim, duke argumentuar se pretendimet e paraqitura nga kërkuesi nuk ishin të reja dhe ato kishin qenë objekt vlerësimi nga kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës gjatë shqyrtimit të kërkesave të mëparshme. Po kështu, Kolegji i ka tërhequr sërish vëmendjen kërkuetit për faktin se ai, pavarësisht se është paralajmëruar disa herë, ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura dhe abuzive, me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe. Kolegji në këtë rast ka vlerësuar mosdërgimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve për caktimin e gjobës.

7. Kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesën e datës 19.01.2023, duke pretenduar anulimin e vendimeve të mësipërme të Gjykatës. Pas kalimit nga Kolegji për shqyrtimin paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, kjo e fundit, me vendimin nr. 71, datë 05.04.2023, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe caktimin e gjobës në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, me arsyetimin se pavarësisht tërheqjes së vëmendjes, kërkuesi ka vijuar me paraqitjen e kërkesave të njëjta dhe abuzive. Në datën 07.08.2023 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës, duke kërkuar, në mënyrë të përmbledhur, parashtrimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike dhe ligjore të çështjes së tij dhe kalimin për shqyrtim në seancë plenare. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 223, datë 31.10.2023, ka

vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkimet ishin objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës.

8. Zyra e Përmbartimit Tiranë, në datën 14.11.2023, pas kalimit të afateve ligjore për ekzekutimin vullnetar, ka filluar procedurat për ekzekutimin e vendimit për caktimin e gjobës. Në datën 19.01.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për revokimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 71/2023. Kërkesa ka kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin nr. 30, datë 14.02.2024, ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit kushtetues, duke vendosur shqyrtimin administrativ të saj.

9. Ndërkohë, kërkuesi, në datën 12.02.2024, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, me objekt: *“Pambarueshmëria e shqyrtimit paraprak të kërkesës nr. P-4 Regjistri Themeltar, datë 21.09.2020, me objekt: Pavlefshmëria e vendimit nr. 1441, datë 14.07.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2020-9, datë 27.05.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Lënien në fuqi të vendimit nr. 6260, datë 13.07.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”*

10. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 85, datë 24.04.2024 (vendimi nr. 85/2024), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkimet e paraqitura ishin objekt i vendimeve të mëparshme të Kolegjeve dhe Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe se kërkesa objekt shqyrtimi përbënte gjë të gjykuar (*res judicata*).

11. Në datën 06.06.2024 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë kërkesë me objekt sqarimin, interpretimin, plotësimin, llogaritjen e vendimit nr. 85/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

12. Me vendimin nr. 158, datë 11.07.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur mospranimin e kërkesës për plotësimin dhe saktësimin e vendimit nr. 85/2024, pasi nuk ndodhej në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

13. Në datën 06.09.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë sipas objektit të sipërcituar.

II

Pretendimet e kërkuesit

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar argumentet si vijon:

14.1. Në vendimin nr. 158/2024 pretendimet nuk shkruhen në mënyrë të plotë e të saktë dhe nuk u jepet përgjigje. Arsyetimi është shumë i errët, për faktin se kërkohet të justifikohet mashtrimi i mosshqyrtimit paraprak të kërkesës

fillestare. Fjalitë më të pakuptimta, të pakuptueshme që shkruhen në vendim janë: “Gjykata shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi.”. Relatorët i lexojnë kërkesat “tangjent”, “diagonal”, “pingul” (pendikular).

14.2. Pretendimet që duhet të marrin përgjigje lidhen me momentin e hyrjes në fuqi të afatit 4-mujor, pra nëse ky afat dhe shterimi i mjeteve juridike kanë hyrë në fuqi me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr. 76/2016) ose në datën 01.07.2013. Këto ligje kanë hyrë në fuqi në datat 11.08.2016 dhe 01.03.2017 dhe nuk mund të zbatohen në datën 01.07.2013. Pretendimeve duhet t’u jepej përgjigje bazuar në vendimin nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës, sipas të cilit ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm nëse cenon të drejtat e fituara me ligje ekzistuese.

14.3. Situata e krijuar lidhur me zbatimin e afatit 4-mujor duhet të saktësohet, sepse cenohet e drejta e fituar me vendimin nr. 6260, datë 13.07.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kur vepronin ligjet e mëparshme dhe Kushtetuta e pandryshuar. Gjykata duhet të saktësojë hyrjen në fuqi të ligjeve nr. 76/2016 dhe nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 99/2016) nëse është data 01.07.2013 ose data 11.08.2016, pasi llogaritjet janë gabim në vendimet e mëparshme dhe zbatimi i nenit 71/a i ligjit nr. 99/2016 është pjesë e ligjit të pamiratur në vitin 2013.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkesit

15. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores parashikohet se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose i Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet. Kryesisht ose me kërkesë të palëve, e cila duhet të paraqitet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit, Kolegji/Mbledhja/Gjykata që ka dhënë vendimin ka të drejtë të plotësojë ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogaritje ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të.

16. Në kuptim të parashikimeve të mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi, si palë pjesëmarrëse në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi nr. 158, datë 11.07.2024, legjitimohet *ratione personae*. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 06.09.2024, pra brenda afatit 2-mujor të parashikuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në kuptim të kompetencës lëndore të Gjykatës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka kërkuar saktësimin në lidhje me datën e hyrjes në fuqi të ligjeve nr. 76/2016 dhe nr. 99/2016 nëse është data 11.08.2016 ose data 01.07.2013, pasi në vendimet e mëparshme në lidhje me kërkesën e tij llogaritja për afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual është bërë gabim. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 158/2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve është shumë i errët, për faktin se kërkohet të justifikohet mosshqyrtimi paraprak i kërkesës fillestare të paraqitur nga ai në vitin 2020, si dhe pretendimet e parashtruara nuk shkruhen në mënyrë të plotë e të saktë dhe nuk u jepet përgjigje.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në vazhdimësi, duke ngritur pretendime si për procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, ashtu dhe për procesin e zhvilluar në Gjykatë, për vendimmarrjen e kolegjeve të saj, duke kundërshtuar parashikimin ligjor për afatin 4-mujor në paraqitjen e ankimit kushtetues individual në vitin 2020. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se si për pretendimet për hyrjen e fuqi të ndryshimeve ligjore për zbatimin e afatit ligjor 4-mujor në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, si dhe për çdo pretendim tjetër kërkuesi ka marrë përgjigje shteruese me vendim të Kolegjit të Gjykatës ose Mbledhjes së Gjyqtarëve.

19. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se argumentet për hyrjen në fuqi të ligjeve nr. 76/2016 dhe nr. 99/2016 nuk janë të natyrës kushtetuese. Për argumentet lidhur me ushtrimin e detyrës nga gjyqtari relator në funksion të shqyrtimit të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se abuzimi me ushtrimin e së drejtës për të paraqitur kërkesë në Gjykatë dhe përdorimi i fjalëve të papërshtatshme e ofenduese, përbën shkak për ta konsideruar si një kërkesë abuzive.

20. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve duke iu referuar pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, vlerëson se nuk ndodhet përpara ndonjërit prej rasteve të parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores, pra që vendimi nr. 158/2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të ketë të bëjë me gabime në shkrim ose pasaktësi, për rrjedhojë nuk ka vend për plotësimin dhe saktësimin e përmbajtjes së vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit.